



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kryetari i Komunës së Klinës

Nr. 401 - 25 998 / 26

Datë: 14.08.2024

NJOFTIM PËR DËGJIMET BUXHETORE

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Klinës hap Dëgjimet Buxhetore lidhur për Draft-Buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2027, nga data 18 gusht deri me datën 7 shtator.

Ftohen të gjitha institucionet komunale, qytetarët, OJQ-të, bizneset, Bashkësitë Lokale, media dhe të interesuarit tjerë që të marrin pjesë në Dëgjimet Buxhetore për:

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i Draft-Planit të Buxhetit për vitin 2027

Të cilat do të mbahen sipas agjendës:

TAKIMI I - Salla e Konferencave, Objekti Komunës Kati III, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave, më datë 27.08.2026, në ora 10:00,

TAKIMI II - SHFMU "Isa Boletini", në Drenoc, më banorët e fshatrave, Drenoc, Pjetërç i Epërm, Pjetërç i Poshtëm, dhe Dugajevë, më datë 28.08.2026, në ora 17:00,

TAKIMI III - SHFMU "Azem Bejta", në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz, Qeskovë, më datë 28.08.2026, në ora 18:00,

TAKIMI IV - SHFMU "Motrat Qiriazhi", në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dollc, Dresnik, Jagodë, më datë 31.08.2026, në ora 17:00,

TAKIMI V - SHFMU "Avni Zhabota", në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë), më datë 31.08.2026, në ora 18:00,

TAKIMI VI - SHFMU “Ali Krasniqi”, në fshatin Ujmirë, me banorët e fshatrave Ujmirë, Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Shtaric, Dush, Resnik, Siqevë, Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Qabiq, Doberdol, më datë 01.09.2026, në ora 17:00,

TAKIMI VII – SHFMU “Emin Duraku”, në fshatin Sferkë, me banorët e fshatrave Sferkë, Gllarevë, Caravik, Volljakë, Qupevë, Zabergjë, Rixhevë, Stapanic, Përçevë, më datë 01.09.2026, në ora 18:00,

TAKIMI VIII - SHFMU “Nënë Tereza”, në fshatin Budisalc, me banorët e fshatrave Zllakuqan, Berkovë, Dranashiq, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Radulloc, Stupë, Rudicë, Videjë, Krushevë e Madhe, Krushëvë e Vogël, Budisalc, më datë 03.09.2026, në ora 17:00,

TAKIMI IX – Salla e Konferencave”, me temë “Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës, më datë 03.09.2026, në ora 16:00,

TAKIMI X - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve, Klinafç dhe Gjurgjevik i Vogël, më datë 04.09.2026, në ora 10:00.-
-Asambleja Komunale e Fëmijëve të Salla e Kuvendit ora 11:30

Materiali në formë fizike mund të merret në zyrën e Drejtorisë së Financave, po ashtu, gjendet edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe Platformën e Konsultimeve Publike:

Komuna Klinë:

<https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/>

Propozimet e juaja lidhur me këto akte mund t’i dorëzoni me shkrim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, kati II dhe Zyrën e Drejtorisë së Financave, kati I, zyra e dytë, ana e djathtë.

Gjithashtu, në mënyrë elektronike tek zyrtarët:

1. Egzon Sejdiu, email: egzon.sejdiu@rks-gov.net
2. Melihate Behramaj, email: melihate.behramaj@rks-gov.net

Mirëpresim propozimet dhe sugjerimet e juaja nga data 18 gusht 2026, gjatë mbajtjes së debatit dhe deri më datë 07 shtator 2026.

Pas përfundimit të fazës së diskutimit publik, propozimet e juaja do të merren në konsideratë duke u shqyrtuar në raportin e konsultimit publik si dhe në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës konform dispozitave ligjore.

Zenun Elezaj

Kryetar i Komunës së Klinës

